



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1705/2 Prot.

Vlorë, më 17.09 2026

PROJEKT VENDIM

“PËR DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT TË PARAKOHSHËM TË MANDATIT TË KËSHILLTARES SË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE ZNJ. LEDJA SHOLLAJ PËR SHKAK TË DORËHEQJES”

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, pjesa e gjashtë “Qeverisja Vendore” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar me Ligjin Nr.38/2019, datë 20.06.2019, nenit 47, pika 1, gërma “c” nenit 49, pika 4, shkronja “b, nenit 53, nenit 57, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.11, datë 30.01.2020 “Për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak Vlorë” neni 21, gërma “b”, dispozitave ligjore Ligjit Nr.10019 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe kërkesës me shkrim për dorëheqje të Znj. Ledja Sholla, depozituar pranë Sekretariatit të Këshillit datë 21.08.2026, me shkresë Nr.17015 Prot, datë 21.08.2026, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës xx.09.2026,

VENDOSI:

1. Të deklaroj përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Vlorë Znj.Ledja Shollaj e zgjedhur nga lista shumëëmërore e subjektit politik Partia Socialiste, për shkak të emërimit në detyrë, Administrator i Rajonit Nr.4, të Bashkisë Vlorë.
2. Të shpall krijimin e vakancës (vendi të lirë) për një mandat anëtar në Këshillin Bashkiak Vlorë.
3. Sekretariati i Këshillit Bashkiak të njoftoj zyrtarisht Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) brenda afatit ligjor, duke i përcjellë këtë vendim së bashku me dokumentacionin përkatës (kërkesën e dorëheqjes) me qëllim fillimin e procedurave për zëvendësimin e këshilltares së rradhës sipas listës shumëëmërore të të njëjtit subjekt, në zbatim të Kodit Zgjedhor.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë sipas përcaktimeve të neni 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

KRYETAR

Elpiniq Mërkuri

Adresa : Sheshi “4 Heronjtë”, www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 17015 Prot.

Vlorë, më 17.09 2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PROJEKT - VENDIMIT “PËR DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT
TË PARAKOHSHËM TË MANDATIT TË KËSHILLTARES SË KËSHILLIT
BASHKIAK VLORE ZNJ. LEDJA SHOLLA PËR SHKAK TË DORËHEQJES”**

Para Këshillit të Bashkisë!

Të nderuar këshilltarë!

Projektvendimi “Për deklarimin e përfundimit të parakohshëm të mandatit të këshilltares së Këshillit të Bashkisë , Znj. Ledja Shollaj” është paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë me qëllim deklarimin zyrtar të dorëheqjes dhe mbarimit para kohe të mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Znj.Ledja Shollaj, e zgjedhur nga lista shumëëmërore e subjektit politik Partia Socialiste.

Këshilltarja ka paraqitur kërkesën me shkrim për dorëheqje nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak, depozituar pranë Sekretariatit të Këshillit datë 21.08.2026 me shkresë Nr.17015 Prot, datë 21.08.2026, për arsye të emërimit në detyrë, Administratore e Rajonit Nr.4, të Bashkisë Vlorë. Në këto kushte jemi përpara përfundimit të afatit të mandatit të këshilltares, në papajtueshmëri me funksionin e këshilltarit , parashikuar nga neni 47, pika 1, gërma “c” si dhe neni 49, pika 4, shkronja “b, të Ligjit Nr.139/2015 , “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar .

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 , “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 49, pika 5, mbarimi i afatit të këshilltarit , deklarohet me Vendim të Këshillit të Bashkisë.

Për sa më lart, i kërkojmë Këshillit miratimin e deklarimit të mbarimit të mandatit para kohe të Znj.Ledia Sholla dhe më pas për të vijuar me procedurat përkatëse me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me procedurën e zëvendësimit të saj me kandidatin/kandidaten tjetër në listën shumëëmërore të subjektit përkatës politik, parashikuar nga neni 164 “ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës”, Ligji Nr.10019 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

Adresa : Sheshi “4 Heronjtë”, www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 17015 Prot.

Vlorë, më 21.08. 2026

Lënda: Njoftim për dorëheqjen nga mandati i anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

KËSHILLIT TË BASHKISË
ZNJ.ELPINIQI MËRKURI
KRYETARE E KËSHILLIT TË BASHKISË

Për arsye se , jam emëruar me detyrën , Administrator i Rajonit Nr 4 të Bashkisë Vlorë, bazuar në Ligjin Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , i ndryshuar, Neni 47, pika 1/c dhe Neni 49, pika 4/b dhe c, ju njoftoj dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Duke ju falëndruar për bashkëpunimin e deritanishëm, shpreh besimin tim se, edhe në të ardhmen Këshilli i Bashkisë Vlorë, do të vazhdojë të ushtrojë funksionet e tij në dobi të qytetit tonë.

ANËTARE E KËSHILLIT TË BASHKISË

Ledja Shollaj



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ✓

Nr. 1468 Prot

Vlorë, më 24.08 2026

V E N D I M
Nr. 721, dt 24.08 2026

“PËR EMËRIM NË DETYRË”

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, nenin 64 të Kreut X, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara - 2026”, Vendimin nr. 228 datë 31.12.2025 i Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2026” i ndryshuar dhe në përfundim të procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendit të lirë në pozicionin “**Administrator**” në Rajonin nr. 4;

V E N D O S A:

1. Të emërohet në detyrën “Administrator” në Rajonin nr. 4, Znj. Ledja Shollaj, me strukturë të pagës 102.000+vjetërsi+14.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Znj. Ledja Shollaj, Rajoni nr. 4 dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Brunilda Mersini

